



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "TR shpk" të datës 24.04.2026 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II" me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "TR shpk" të datës 24.04.2026 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II" me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "TR shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 24.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II" me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: “Për çfarë arsye janë kërkuar këto pajisje me specifikime kaq të detajuara teknike?

Pse është kërkuar që fshesa rrugore të ketë peshë specifike (p.sh. 1800 kg), ndërsa nuk lejohen variante të tjera si 1900 kg apo 2100 kg?

Pse është përcaktuar fuqia prej vetëm 11 kW për fshesën dhe nuk janë pranuar variante me fuqi më të madhe (p.sh. 20 kW apo 30 kW)?

Për Lotin 2, pse është kërkuar traktor me fuqi 50 kW pa u specifikuar kufi minimal apo maksimal dhe a lejohen alternativa me fuqi 25 kW, 35 kW, 60 kW apo 100 kW?

Pse janë përcaktuar dimensione kaq specifike për traktorin (p.sh. minimum 900 mm – maksimum 1000 mm dhe minimum 1000 mm – maksimum 1150 mm)?

Për çfarë arsye është kërkuar që traktori të ketë kabinë dhe lopatë, dhe a është kjo një kërkesë funksionale apo një preferencë specifike?

Pse është kërkuar furgon elektrik me fuqi 40 kW, kur për kryerjen e shërbimeve të njëjta mund të përdoren edhe furgonë me naftë apo benzinë?

Për çfarë arsye janë kërkuar gjithashtu tre pick-up apo furgonë shtesë 3 furgon apo pikap pse është kërkuar elektriku kur janë 3 pikap me naftë apo dizell apo benzinë pse të jetë elektrik na spejgo me qfar arsye jet ky lloj furgoni?”

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se në fakt nuk është prezantuar asnjë pretendim ankimor dhe as që është kërkuar të ndryshohet ndonjë kërkesë e DT por vetëm janë parashtruar pyetje për sqarimin e kërkesave ekzistuese të DT. Rrjedhimisht duhet cekur se afati për sqarime të DT ka qenë i përcaktuar deri me datë 01.04.2026 dhe AK ka ofruar përgjigje në të gjitha kërkesat e OE për sqarime.

Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 28.04.2026**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.